| | | | |
| | **TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA(II)** | **1,127,006,860** | **1,130,782,860** |
| | | | |
| | **TOTALI AKTIVEVE (I + II)** | **1,158,713,428** | **1,162,489,428** |

**ADMINISTRATORI**
**Nexhip Meçi**

DINAMO SHA
J61819012V
TIRANE - ALBANIA

``DINAMO`` SHA

| B | PASIVI | Para zmadhimit te kapitalit | Pas zmadhimit te kapitalit |
|---|---|---|---|
| I | **DETYRIMET DHE KAPITALI** | | |
| I | **DETYRIMET AFATSHKURTERA** | | |
| 1 | **Derivativet** | - | - |
| 2 | **Huamarrjet** | - | - |
| | (i)Huate dhe obligacionet afatshkurtera | - | - |
| | (ii)Kthimet/ripagesat e huave afatgjata | - | - |
| | (iii)Bono te konvertueshme | - | - |
| | **Totali 2** | - | - |
| 3 | **Huate dhe parapagimet** | | |
| | (i)Te pagueshme ndaj furnitoreve | 7,279,192 | 7,279,192 |
| | (ii)Te pagueshme ndaj punonjesve | 3,035,419 | 3,035,419 |
| | (iii)Detyrimet tatimore+sig.shoqerore | 1,125,486 | 1,125,486 |
| | (iv)Hua te tjera | 33,271,690 | 33,271,690 |
| | (v)Parapagimet e arketuara | - | - |
| | **Totali 3** | **44,711,787** | **44,711,787** |
| 4 | **Grantet dhe te ardhurat e shtyra** | - | - |
| 5 | **Provizionet afatshkurtera** | - | - |
| | | | |
| | **TOTALI DETYRIMEVE AFATSHKURTERA (I)** | **44,711,787** | **44,711,787** |
| | | | |
| II | **DETYRIME AFATGJATA** | | |
| | | | |
| 1 | **Huate afatgjata** | - | - |
| | (i)Hua,bono dhe detyrime nga qeraja financiare | - | - |
| | (ii)Bonot t konvertueshme | - | - |
| | **Totali 1** | - | - |
| 2 | **Huamarrje te tjera afatgjata** | - | - |
| 3 | **Provizionet afatgjata** | - | - |
| 4 | **Grantet dhe te ardhurat e shtyra** | - | - |
| 5 | **Diferenca konvertimi pasive** | - | - |
| | **TOTALI I DETYRIMEVE AFATGJATA (II)** | | |
| | | | |
| | **TOTALI I DETYRIMEVE** | **44,711,787** | **44,711,787** |
| | | | |
| III | **KAPITALI** | | |
| 1 | Aksionet e pakices (perdoret vetem ne pasqyrat financiare) | - | - |
| 2 | Kapitali qe i perket aksionereve te shoqerise meme | - | - |
| 3 | Kapitali i regjistruar (aksioner) | 165,066,000 | 168,842,000 |
| 4 | Primi i aksionit | - | - |
| 5 | Njesite ose aksionet e thesarit(negative) | - | - |
| 6 | Rezerva statutore | - | - |
| 7 | Rezerva ligjore | 5,341,254 | 5,341,254 |
| 8 | Rezerva te tjera | 839,480,799 | 839,480,799 |
| 9 | Fitimet (humbja) e pashperndare | 84,753,046 | 84,753,046 |
| 10 | Fitimi (humbja) e vitit financiar | 19,360,542 | 19,360,542 |
| | | | |
| | | | |
| | **TOTALI I KAPITALIT (III)** | **1,114,001,641** | **1,117,777,641** |
| | | | |
| | **TOTALI I DETYRIMEVE TE KAPITALIT (I,II,III)** | **1,158,713,428** | **1,162,489,428** |

**ADMINISTRATORI**
**Nexhip Meci**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DINAMO SHA
NIPT J61819012V
TIRANE-ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT
TIRANE

Nr.16. Rregjistri Themeltar
Nr.979. I Vendimit

# V E N D I M

**"NE EMER TE REPUBLIKES"**

Gjykata e Apelit Tirane e perbere prej :

| | |
|---|---|
| KRYESUES | : METUSH SARAÇI |
| ANETAR | : FATOS QATO |
| ANETAR | : PAJTIM HOXHA |

Me sekretare gjyqsore Miranda Gignasi, sot me dt.24.07.2009, mori ı shqyrtim çeshtjen civile me Nr.16 Akti, qe u perket paleve :

**PADITES** : **Sh.A "Uzina Dinamo"**

**I PADITUR** : **1.Trashegimtaret e te ndjerit Ferit Katroshi:**

**a – Kimete Katroshi**
**b – Hasan Katroshi**
**c – Majlinda Katroshi**
**ç – Fatjon Katroshi**

**2.Trashegimtaret e te ndjerit Refik Katroshi :**

**a – Liljana Kraja ( Katroshi)**
**b – Sujelman Katroshi**
**c – Majola Mako (Katroshi)**

**3.Nadire Hasan Katroshi**
**4.Ikbale Hasan Katroshi**
**5.Laerta Demiri**
**6.Gazmir Demiri**

7.Xhaferr Demiri
8.Florida Demiri
9.Violeta Katroshi
10.Mirela Katroshi
11.Etleva Katroshi
12.Foto Sava
13.Myrteza Gjashta
14.Zyra Rajonale e Kthimit dhe Kompesimit te Pronave.

**OBJEKTI : Anullimin e vendimit Nr.145 date 30.06.1995, Nr.80 date 05.11.1999 dhe Nr.314 dt.16.09.2000 te K.K.Pronave.**
**Konstatimin nul te te gjitha veprimeve juridike te kryera mbi bazen e ketyre vendimeve te K.K.P si dhe rregjistrimeve hipotekore si rregjistrime absolutisht te pavlefshme qe vijne ne kundershtim me ligjin.**

**Baza Ligjore : Neni 158/a i K.Pr.Civile.**
**Ligji Nr.7698 date 15.04.1993 "Per kthimin dhe kompesimin e pronave ish pronareve" si dhe udhezimi i KM, Nr.3 date 21.06.1993.**

**Gjykata e Rrethit Gjyqsor Tirane,** me vendimin Nr.7529 date 22.12.2006 ka pranuar padine.

Kunder vendimit kane bere ankim te padituri dhe parashtrojne :

***I padituri Myrteza Gjashta :***

- Paditesi nuk legjitimohet ne ngritjen e padise mbasi nuk eshte pronar i tokes, nuk ka interes te ligjshem ne ngritjen e padise.
- Vertetimi hipotekor nr.92 eshte i pa sakte dhe i manipuluar.
- Gjykata nuk ka marre parasysh kerkesen e paleve per grup ekspertesh pasi ekspertimi u krye nga 1 ekspert.
- Ankandi i privatizimit te Uzines filloi ne 2001 ndersa vertetimi i pronesise eshte i vitit 2000.
- Privatizimi ka filluar me siperfaqe 43958 m2 ndersa vertetimi pronesise permban 46218 m2.
- Vendimet e K.K.K.Pronave kane kthyer pronen te zotet.
- Nota e transkiptimit n.899 dt.24.11.39 eshte shitja e pronave nga Sulejmani te djemte Hasan e Shaqir Katroshi te cilet blene nga 7.5 dynym qe do te thote se ka qene 15 dynym.

- Vendimi i gjyqit te paqit ku thuhet se Sulejman Katroshi zoteron 15 dynym toke.

Persa u tha kerkojme prishjen e çeshtjes dhe kthimin e saj per rigjykim.

***Te paditurit e tjere***

1. Prona e kthyer me vendimin Nr.145 date 30.06.94 nuk perfshihet ne pasurine e "Uzines Dinamo", per rrjedhoje kjo e fundit nuk legjitimohet ne ngritjen e kesaj padie. Trualli shoqerise eshte 43958 m2.
2. Gjykata nuk ka patur parasysh dokumentat shkresore te kalimit te pronesise nga shteti te pala paditese.
3. Ekspertimi eshte i pa sakte dhe nuk i ka dhene pergjigje problemeve te gjykimit. (Ne dosje ndodhen edhe akt – ekspertime qe vertetojne te kunderten e ketij ekspetimi).
4. Gjykata shprehet se familja Katroshi nuk eshte subjekt i ligjit per arsye se nuk ka ndonje vendim shpronesimi dhe se Hasan e Shaqir Katroshi e kane shitur 10.100 m2, por qe 4.900 m2 i ka mbeur Hasan Katroshit.

Trashegimlenesi Hasan ka vazhduar te jete pronar. Provat e ndodhura ne dosje vertetojne se vellezerit Katroshi kane patur 15.000 m2 toke ne pronesi, kane shitur 10.100 m2 ndersa 4.900 m2 mbeti prone e Hasanit deri sa e mori shteti ne zbatim te ligjeve per kalimin ne pronesi te gjith tokes te shteti.

Kerkojme te merren si prova kontrata e shitjes dhe harta per shitjen e truallit nga shteti tek Uzina.

Persa u tha kerkojme ndryshimin e vendimit dhe rrezimin per vendimin nr.145 dt.30.06.1995 te K.K.K.Pronave.

## GJYKATA APELIT TIRANE

Mbasi degjoi relatimin e çeshtjes, avokatin e paditesave Avni Shehu qekerkoi pranimin e ankimit, avokatin e te paditurit Myrteza Gjashta Fadil Kaloshi qe ishte per pranimin e ankimit, avokatin e anes paditese Erinda Ballanca dhe Nexhdet Kambo qe kerkuan lenine ne fuqi te vendimit si e shqyrtoi dhe analizoi çeshtjen ne teresi,

## V E R E N

Ne fillim te shqyrtimit te çeshtjes nga gjykata e Apelit u konstatua se dy nga te paditurit ne kete proçes kane vdekur mbas dhenies se vendimit nga gjykata e shkalles se pare ata jane Ferit Hasan Katroshi dhe Refik Hasan Katroshi, per kete mbasi i realizua deshmia perkatese e trashegimise dhe te cilet u percaktuan trashegimtaret e tyre ligjore ( me vendim te formes se prere te gjykates). Gjykata e Apelit ne perputhje me kerkesat e nenit 199 te K.Pr.Civile beri kalimi

procedurial duke thirrur si te paditur ne vend te tyre trashegimtaret ligjore te secilit duke vazhduar keshtu rregullisht shqyrtimin gjyqsor te çeshtjes.

Nga gjykimi i çeshtjes ne gjykaten e shkalles se pare eshte pranuar se :

Komisioni i Kthimit dhe Kompesimit te Pronave prane Bashkise Tirane me vendimin Nr.145 dt.30.06.1995 nder te tjera ka vendosur " ish pronarit Hasan Katroshi (trashegimtarve te tij sipas N.1 te Ligjit 7698 dt 15.04.1993 i njihet pronesia e nje toke ndodhur ne lagjen Ismail Efendi, Sinurin Allias me siperfaqe 7 dynym e gjysem, gjysma e saj nga ana e jugut qe kufizohet Met Daja, perendimi me trashegimtaret Sefer Fortuzi, veriu me gjysmen tjeter qe mori Shaqir Katroshi e jugu Osman e Hamdi Maloku".

Ne vazhdim me vendimin Nr.145 thuhet : prona kthehet dhe kompesohet si vijon : truall i lire me siperfaqe te pergjithshme 3951 m2 qe gjendet ne dy parcela "S", me siperfaqe 2951 m2 brenda tertorit te Uzines Dinamo dhe "S2" me siperfaqe 965 m2 jasht territorit te Uzines Dinamo. Ne baze te nenit 19 i njihet dhe kthehet pronesia mbi dy troje.

Pronesia mbi dy trojet e sipershenuara truall S, kur te behet privatizimi i Uzunes Dinamo, ndersa trualli S2 i kthehet pronarit menjehere.

Ne pikat 1/b dhe 1/c ish pronarit i eshte dhene e drejta e parablerjes sipas kerkesave te nenit 21 te ligjit.

Sipas vendimit te komisionit prona figuron e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor me nr.314 dt.24.04.1942.

Me vendimin Nr.80 dt.05.11.1999 pika 1 u nihet pronesia ish pronarit Shaqir Katroshi (trashegimtareve te tij te pasiturit Myrteza Gjashta) ne baze te nenit 1 te Ligjit 7698 dt.15.04.1995 siperfaqja e truallit S = 7500 m2. Ne piken 1/b te ketij vendimi te padituritt Myrteza i eshte kthyer trualli me siperfaqe 4500 m2 ndersa ne piken 1/c te vendimit per siperfaqen 2895 m2 i jepet e drejta e parablerjes te objekteve i sipas specifikimeve ne kete pike.

Me vendimin Nr. 314 dt. 16.09.2000 te ketij komisioni eshte vendosur qe te kthehet ne pronesi siperfaqja prej 1590 m2.ne te dy keto vendime pra ne N.80 dhe ne ate me N.314 si kufij te prones jepen ato te pershkruara ne rregjistrimin hipotekor N.313 dt.24.04.1942 pra me Adem Kallushi, trashegimtaret e Sefer Mal Fortuzi, Mehmet Daja e nga jugu me Hasan Katroshin.

Ka rezultuar gjithashtu se paditesi, shoqeria anonime "Dinamo" eshte krijuar nga transformimi e ish ndermarrjes shteterore "Uzina Dinamo" ne shoqeri tregtare si person juridik me vendimin Nr.12870 dt.27.11.1995 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Kjo shoqeri ne fillimet e saj kishte si aksione te vetem shtetin dhe kapitali perbehej nga trualli, godinat, paisjet etj, i rregjistruar ne rregjistrin tregtar, pjese e te cilit eshte e rregjistruar ne Zyren e Rregjistrimit te Pasurive te Paluajteshme (sipas vertetimit Nr.92 dt.26.06.2000 qe mban Nr.374.

Per shkak te mbivendosjes te pronave te sh.a "Dinamo" dhe asaj te kthyer nga K.K.K.Pronave ne favor te te padituve eshte krijuatr konflikti zgjidhja e te cilit perben dhe objektin e ketij gjykimi. Gjykata e Shkalles se Pare pasi ka marre te gjitha provat e paraqitura nga palet dhe ka shqyrtuar e analizuar ne teresi çeshtjen ka arritur ne perfundimin se padia eshte e bazuar dhe ka konkluduar ne pranimin e saj duke anulluar tre vendimet e K.K.K.Pronave ate me Nr.145, 80

dhe 3.14. Gjykata kete perfundim e argumenton me kerkesat dhe kriteret e vendosura nga Ligji Nr.7698 dt.15.04.1993 si dhe me provat referuese duke pranuar se ne veshtrim te Ligjit per Kthimin dhe Kompesimin e Pronave ish pronareve, trashegimtaret e Hasan e Shaqir Katroshit nuk jane subjekt te ketij ligji e si te tille ata nuk mund te perfitojne.

Ligji ne fjale kerkon te plotesohen dy kushte qe te mund te perfitohet prej tij. Se pari te keshe qene pronar deri ne momentin e marrjes se prones (pas dt.29.11.1944) dhe se dyti te kete nje akt te organeve te pushtetit te asaj kohe per marrjen e prones. Gjykata bazuar ne aktet dhe ne provat e administruara ka konstatuar se ne rastin ne shqyrtim per te paditurit nuk ekziston asnje nga te dy kriteret e vendosuara nga ligji. Vertetimi i pronesise eshte i dates 24.04.1942 dhe se nuk ka asnje prove qe te tregoje se toka i eshte marre te padituve nga shteti monist pas dates 29.11.1944 ne nje nga format e njohura si shtetzim, konfiskime etj.

Kjo prone ka ne origjine rregjistrimin hipotekor nr.889 dt.24.11.1939 me pronar Sulejman Katroshi ( i ati i Hasan dhe Shaqir Katroshi) i cili ishte pronar i nje sip. toke prej 7.5 dynym e ndodhur ne lagjen Ismail Efendi, Sinuerin Allias me kufizimet Adem Kallushi, trashegimtaret e Met Fortuzit, Mahmut Dajes (me pare Ahmet Husha) dhe Hamdi e Osman Maloku.

Komisioni qe i ka kthyer pronen te padituve me vendimin Nr.145 dt.30.06.1995 bazohet ne rregjistrimin hipotekor Nr.314 viti 1942, kur vertetohet se prona sipas ketij rregjistrimi hipotekor eshte traskiptuar teresisht ne rregjistrin hipotekor Nr.88 dt.30.01.1943 ne favor te shtetit sipas aktiti te shitjes.

Po ashtu K.K.K.Pronave ne vendimin Nr.80 dt.05.11.1999 dhe ne vendimin Nr.314 dt.16.09.2000 eshte mbeshtetur ne rregjistrimin hipotekor Nr.889 dt.24.11.1939.

Sipas ketij rregjistrimi prona figuron te jete e rregjistruar ne emer te Hasan e Shaqir Katroshit kunder Sulejman Katroshit (babai i tyre). Mbas rregjistrimit Nr.889 dt.24.11.1939 prona ka kaluar ne favor te Shaqir Katroshit sipas rregjistrimit hipotekor me Nr.313 dt.24.04.1942 dhe Hasan Katroshit sipas rregjsitrimeve prona eshte transkiptuar teresisht ne rregjsitrin hipotekor Nr.88 date 30.11.1943 ne favor te shtetit me kontrate shitje. Ne kete kontrate percaktohen kufijte e prones te cilat mbeshteten ne rregjisrimet hipotekore Nr.313 dhe Nr.314 dt.24.04.1942 duke u shprehur si nje shitje truprisht e jo me matje .... kjo percaktohet edhe sipas kufizimeve te pranonesise sipas rregjistrimit hipotekor me Nr.889 dt.24.11.1939. Sipas dokumentave figuron se levizja e kesaj prone eshte nga Sulejman Katroshi, ne favor te djemve te tij Shaqir e Hasan ku thuhet se nje cope toke prej shtate dynym e gjysem e kufizuar nga Adem Kallushi,

Sefer Fortuzi, Mehmet Daja dhe Hamdi Maloku. Pas ketij pjestimi te tokes ndermjet djemve Shaqir e Hasan prona transkiptohet ne rregjister me Nr.313 dt.24.04.1942 ku thuhet : ne favor te Shaqir Katroshit gjysmen e tokes te ndodhur ne lagjen Ismail Efendi ne sinurin Allias me kufizime veriu Adem Kallushi, jugu gjysmen tjeter qe mori Hasan Katroshi, lindja Mat Daja dhe perendimi Sefer Fortuzi. Ne noten e transkiptimit Nr.314 dt.22.04.1942 thuhet se ne favor te Hasan Katroshit prej tokes se ndodhur ne Lagjen Ismail Efendi te Tiranes me

sipërfaqe 7.54 dynym gjysma e saj nga ana e jugut me kufizime lindja Met Daja, perendimi trashegimtaret e Sefer Fortuzi, veriu gjysmen tjeter qe mori Shaqir Katroshi dhe jugu Osman Maloku. Pra sipas kufizimeve te prones te mbeshtetur ne rregjistrimet hipotekore N.889 viti 1939 dhe transkiptimeve N.313 dhe 314 te vitit 1942 dhe rregjistrimit hipotekor Nr.88 viti 1943, kufizimet e prones jane te njejta si konkluzion thuhet se ç'fare ka patur brenda ketyre kufijve te pershkruara ne rregjistrin hipotekor N.88 dt.30.01.1943 prona eshte shitur trupnisht me kontrate shitje.

Parregullsia, pathemelsia dhe pabazueshmeria e vendimeve te K.K.K.Pronave qe goditen ne kete gjykim, qendron jo vetem ne argumentin e siperpermendur, por edhe ne faktin se te tre vendimet ju kthejne te paditurve ne total siperfaqen e truallit prej 18.038 m2, rrethane kjo qe sjell bindjen per konfuzionin dhe paqartesine e ketyre vendimeve.

Konkretisht arsyeton gjykata e shkalles se pare me vendimin Nr.145 dt.30.06.1995 pika 1, K.K.K.Pronave u ka njohur pronesine me 7.5 dynym dhe u ka kthyer te lire pjeserisht sipas pershkrimit (ne piken 1/a per trashegimtaret e Hasan Katroshit, Refik Katroshi etj (perjashtuar Myrteza Gjashta).

Me vendimin Nr.80 K.K.K.Pronave dt.05.11.1999 ka njohur ish pronar trashegimtaret e Shaqir Katroshit (Myrteza Gjashta) per nje siperfaqe prej 8.119 m2 (duke j'a kthyer atij pjeseerisht).

Me vendimin Nr.314 ky komision u ka njohur dhe kthyer te paditurve siperfaqen 1519 m2. Ne total keto siperfaqe te njohura (apo kthyera) te padituve perbejne 18.038 m2 ne nje kohe kur ne origjine rezulton qe te jete siperfaqja prej 7.5 m2.

Kontradita dhe pabazueshmeria e ketyre vendimeve del edhe nga arsyetimi dhe konkluzioni qe buron prej tyre keshtu ne vendimin Nr.145 thuhet se siperfaqja e pergjithshme e Shaqir e Hasanit prej 15.000 m2, administrates ushtarake j,u shiten 10.100 m2 (ndersa provohet se Shaqiri e ka shitur gjithe pjesen e tij 7.500 m2) ndersa Hasani 2.6000 m2. Keshtu qe vetem Hasanit duhet t'i kete mbetur 4.900 m2.

Ne vendimin Nr.80 te Komisionit nder te tjera thuhet ....duke u mbeshtetur ne harten e vitit 1937 – 1993 ne perfundim njihet pronar Shaqir Katroshi per siperfaqen 9.019 m2.
Kjo ne nje kohe kur është provuar se rregjistrimet Hipotekore nr.313, 314 të vitit 1942 e gjithë toka është traskrptuar në favor të shtetit në Nr.88 të vitit 1943.

Një argument domethënës që krijon bindje se e gjithë toka e të padituve ka kaluar në favor të shtetit të kohës nëpërmjet shitjes është edhe fakti sipas hartës së shpronësimit të kohës toka e të padituveka qënë në qëndër të sipërfaqes të tokës të shpronësuar për interesa ushtarake (Demonias) në këtë mënyrë përjashtohej mundësia që kjo tokë të jetë marë (blerë pjesërisht pasi rethohej nga toka të pronarëve të tjerë të shpronësuar dhe keto e që figurojnë në këtë hartë shpronësimesh. Pra me të drejtë në këto rrethana gjykata ka arritur në konkluzionin se K.K.K.Pronave ka administruar dhe vendosur mbi një tokë e cila nuk ka qënë e të padituve ajo është tjetërsuar para dt.29.11.1944 në favor të shtetit, në këtë mënyrë komisioni ka tejkaluar caqet e kompetencave duke

mosrespektuar kërkesat e ligjit "Për kthimin dhe kompesimin e pronave ish pronarëve".

Kjo rrethanë qartësohet edhe nga harta shoqëruese e aktit të shitjes të kësaj prone ku kufiri i kazermave përputhet plotësisht me planin rregullues.

Në këtë hartë përcaktohen emrat e pronarëve konfiguracioni dhe kufiri i pronave të përcaktuar në planin rregullues të vitit 1940, kjo hartë është e shkalles 1/1000. Aty dallohen kufijtë e pronave para shitjes si dhe kufijtë në hartën e shitjes **Demonias**. Një provë kjo shumë domethënëse në favor të shitjes totale të pronës të administruar nga komisioni në të tre vendimet e tij.

Gjykata me të drejtë e ka shtrirë hetimin e çështjes dhe ka sqaruar në mënyrë të plotë e të gjithanshme, rrethanat e kalimit të pronës të të paditurve në favor të shtetit. Gjykata nuk është mjaftuar vetëm me sqarimin e faktit të sasisë të tokës që është shitur nga trashgimlënësit e të paditurve por në mënyrë të detajuar ka "ndriçuar" edhe bazueshmerine e këtij veprimi sipas ligjeve të kohës. Nga materialet e ndodhura në dosje është qartësuar se toka e të paditurve është marë duke u respektuar plotësisht ligjet dhe rregullat egzistuese.

Paraprakisht kanë dalë aktet përkatëse sipas të cilave mund të bëhej nga shteti shpronësimi për interesa publike duke shpjeguar se cilët organe e kishin këtë të drejtë dhe kush ishin interesat publike pas kësaj ka dalë akti (Dekreti i nëkëmbësit i cili përcakton procedurën), dekret ky që ka hyrë në fuqi me shpallje ne gazetën zyrtare. Në dt.30.07.40 Mëkëmbësi i Mbretit ka dekretuar në një nen si interes publik, ndërtimin e gazermave të artilerisë në Tiranë me të cilin tregohen dhe emrat. Ky dekret u botua në Gazetën Zyrtare nr.435 dt.02.09.40. Pas kësaj ka dalë dekreti i Ministrit përkatësi (punëve botërore), ku përcaktohen ndërtimet dhe pronat (përmendet ndër të tjerë Sul Katroshi, Mehmet Daja etj). Bashkëlidhur është dhe harta e zonës ku përfshihet familja katroshi duke përcaktuar me Numra toka e sejcilit nga pronarët e shpronësuar.

Prona e tyre sipas hartës të vitit 1928 është e njëjtë me atë të vitit 1940 dhe njëjtë me Uzinën Dinamo në vitin 1960 dhe sot. Në këtë pra përfshihet edhe toka e familjes Katroshi.

Ne notën e transkriptimit në favor të Demonia se shtetit dt.05.01.1943 provohet plotësisht se "… zotërinjtë Hasan e Shaqir Katroshi, familja katroshi kundrejt një çmimi komplesiv franga shqiptare 23195 dhe një shpërblim okupimi 4% në vit që janë 2097 franga shqiptare gjithsej 25292 të pagume dhe të numëruara tërësisht në dorë, i shitme definitivisht dhe jetërsuar Demonias së Shtetit….. Shitja u bë trupnisht e jo me matje ekzaktësisht. Pra kundravlera në franga është marë në dorë para noterit gjë që e bën të besueshme këtë fakt është pasqyrimi konkret i veprimit të likuidimit në aktin e redaktuar nga noteri e të provuar kundrejt nënshkrimit nga palët dhe noteri. Gjë kjo që nuk lë hapsirë për të vënë në bisedime edhe këtë çështje.

Kjo rrethanë e rëndësishme pra evidentimi nga gjykata i ligjit egzistues dhe procedurës të ndjekur për marrjen e tokës të të paditurve nga shteti i kohës plotëson në mënyrë të plotë ciklin se në rastin konkret jo vetëm bëhet fjalë për të gjith pronën që disponónin trashgimlënësit e të paditurve por se kjo pronë është tjetërsuar prej tyre në favor të shtetit (para vitit 1944), në bazë të ligjit duke u respektuar të gjitha rregullat e parashikuar në aktet normative e duke u

realizuar një kontratë shitblerje e cila është ekzekutuar plotësisht nga të dy palët me kontratë d.m.th. shteti ka marë tokën dhe shitsat kanë marë kundravlerën. Në këtë vështrim gjendet i bazuar dhe i argumentuar vendimi i gjykatës për pranimin e padisë të paditësit.

Veç argumenteve të përmendura më lart gjykata argumenton dhe sjell edhe arsyetime të tjera ne mbështetje të konkluzionit se vendimet e komisionit janë të gabuara e të pambështetura në ligje dhe në prova. Si të tillë përmend faktin se vendimet e komisionit disponojnë mbi territorin e paditësit pra brenda murit të saj rrethues i cili eshtë i vjetër e i pandryshuar që nga themelimi i kësaj qendre që e ka themelimin në vitin 1960 por që ka të njëjtin konfigurim në hartat e vitit 1928 dhe 1942. Në kuptim të ligjit 7698 kjo sipërfaqe trualli konsiderohet e zënë ( pjesa më e madhe ka ndërtime të përhershme e në pjesët e tjera janë teknologjike rrugë ambiente të karakterit funksionale) sipas përcaktimeve të akteve ligjorë e nënligjorë për këtë fushë.

Të tre vendimet e komisjonit kanë mbivendosje me truallin me pronësi të "Uzinës Dinamo" duke njohur e kthyer ish pronarëve një tokë të zënë pjesë e kapitalit të paditësit, pra dhe në këtë aspekt vendimet janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit të sipërpërmendur. Nga provat del se paditësit ka në pronësi (pra brenda rrethimit) sipërfaqja 46.218 m2 truall e cila është pjesë e kapitalit. Ndërsa rezulton se janë bërë përpjekje dhe janë kthyer veprime nga ish ortaku shtet për të zvogëluar këtë pjesë të kapitalit në masen 2980 m2, por që ende nuk është definuar një veprim i tillë. Vetë nga ana e tyre kjo çështje i është referuar zgjidhjes gjyqsore gjë që e mbyll alternativën e pretenduar nga të paditurit në çështje.

Vetë "Uzina Dinamo" është regjistruar si person juridik kohë më parë sesa tju kthehej trualli ish pronarëve me vendimet e K.K.K.P.

Për të gjitha këto çmohet se përfundimet e aritura nga gjykata e shkallës parë janë të drejta, ato gjenden të mbështetura në prova dhe në ligje dhe si të tilla nuk ka bazë të justifikuar për të sjellë ndryshime me vendimin e dhënë nga gjykata.

Pretendimi i bërë me ankimin nga të paditurit në lidhje me moslegjitimimin e paditësit për të ngritur këtë lloj padie, nuk qëndron, nuk ka bazë ligjore dhe vjen ndesh me parimet e ndërtimit të ligjit si dhe me parashikimet e vetë kushtetutës. Çdo person (fizik ose juridik) që pretendon se i mohoet apo i shkelet, cënohet një interes i tij i ligjshëm ka të drejtë ti drejtohet gjykatës me padi.

Pra padia është mjeti me anë të së cilit mund të mbrohen apo realizohen të drejtat nga subjekte të ndryshëm, dhe pikërisht per shkak se paditësit i është shkelur një e drejtë shumë e rëndësishme siç është marrja e pronës nga një akt i paligjshëm i një organi të administratës shtetërore ka çfrytezuar këtë të drejtë themelore të njohur e të sanksionuar nga ligji, pra të drejtën e ngritjes të padisë. Padia e ngritur prej paditësit nuk është abuzive, nuk është nga ato të cilat janë të lidhura ngusht me personin (për personat fizik si zgjidhja e martesës etj) cila nuk mund të ngrihet përkundrazi në rastin e dhënë janë kushtet klasike kur mund të përdoret kjo lloj mbrojtjeje, prandaj vlerësohet se paditësi është i legjitimuar plotësisht me ketë padi në të cilën rezulton që të

jenë respektuar kërkesat e ligjit procedurial si përsa i përket përfaqsimit ashtu edhe momenteve të tjera esenciale.

Marja që i bëhet pronës (pjesë e kapitalit të shoqërisë) cënon haptaz interesat e këtij personi juridik duke rezikuar funksionimin normal si dhe shpërbërjen apo falimentimin e shoqërisë, prandaj nëqoftëse do ti mohoej e drejta elementare që ky person të mos ketë të drejtë të mbrohet me anë të padise atëherë nuk do të kishte asnjëlloj garancie për funksionimin dhe egsistencën e personave juridikë e shoqërive tregtare etj, të cilat përbëjnë elementët e domosdoshëm të sistemit shoqëror egsistues i cili është i parashikuar dhe i garantuar nga tërësia e akteve ligjore e nënligjore në Republikën e Shqipërisë.

Në këtë kuptim çmohet dhe vlerësohet si një pretendim pa bazë fakti i moslegjitimimit të paditësit në ngritjen e kësaj padie. Po kështu gjykohet se dhe për pretendimet e tjera të ngritura në ankim nuk qëndrojnë, ato janë trajtuar dhe kanë marë përgjigje gjatë shqyrtimit të çështjes dhe arsyetimit të vendimit si rrjedhim nuk u kostatua ndonjë arsye që të bazojë ndryshimin e vendimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë.

**PËR KËTO ARËSYE**

Gjykata e Apelit e bazuar dhe në nenin 466/a të K.Pr.Civile

**VENDOSI**

Lënien në fuqi të vendimit civil nr.7529 datë 22.12.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Tiranë.

**Tiranë, më 24.07.2009.**

**A N Ë T A R**
**Pajtim HOXHA**
**Dv**

**A N Ë T A R**
**Fatos QATO**
**dv**

**K R Y E S U E S**
**Metush SARAÇI**
**dv**

**Vertetohet njesia me origjinalin**
**K A N C E L A R E**
**Entela DOBI**

PULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISË

PULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISË

REPUBLIKA E SHQIPERISË GJYKATA E APELIT TIRANË

# VENDOSJA E UZINES DINAMO

## SH 1:1000

UFIRI I UZINES DINAMO
SIP.46218M2
AS KONTRATES SHITJES DT.19/11/1999
43958M2





Uzina Dajti
Shkollë mencë magazinë
Platform
Magazin
Reparti axhusterisë
Rep. Kovaçanës
Zona A+B
SA = 4715 m2
12-03-1999
Rexhep

KATROSHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA QYTETIT TIRANËS
KOMISIONI KTHIMIT DHE KONPENSIMIT
TË PRONAVE ISH PRONARËVE I
RAJONIT NR.1
Nr. prot. 145

Tiranë, më 30.06.1995

# VENDIM

Nr. 145 dt. 30.06.95

## PËR
## KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE

Komisioni i kthimit dhe kompensimit të pronave ish pronarë i Rajonit nr. 1 të Bashkisë së Tiranës, sot më datë 30.06.1995, mori në shqyrtim kërkesën e ish pronarit Hasan Katroshi me nr.1643 të aktit, me objekt kthimin e pronës së përbërë prej një toke ndodhur në lagjen Ismail Efendi, në sinurin Hallias me sipërfaqe shtatë dynym e gjysëm, gjysmën e saj nga ana e jugut.

Prona figuron e regjistruar në regjistrin ipotekor nr. 314 datë 24 prill 1942, kufizuar: Lindja Met Daja, Perëndimi trashëgimtarët e Sefer Fortuzit , Veriu me gjysmën tjetër që mori Shaqir Katroshi e Jugu Osman e Hamdi Maloku.

Gjithashtu në regjistrin Ipotekor, nr. 313 datë 24 prill 1942 në pronësi të Shaqir Katroshit figuron e regjistruar gjysma e tokës e ndodhur në lagjen Ismail Efendi, në sinurin e Halliasit me sipërfaqe shtatë dynym e gjysmë duke pasur për kufinj gjysma: nga Veriu Adem Kallushi, nga Jugu me gjysmën tjetër të tokës që do të marrë Hasan Katroshi, nga Lindja Met Daja dhe nga Perëndimi Sefer Fortuzi (trashëgimtarët e tij).

Gjithashtu në transkiptimin nr. 88 datë 30 janar 1943 theksohet se Shaqir e Hasan Katroshi i është shitur për përdorim administratës ushtarake një copë toke e ndodhur në lagjen Ismail Efendi të Tiranës, në sinurin Hallias me sipërfaqe toke 10100 m², kufizuar: Lindja Met Daja, Jugu Hamdi e Osman Maloku, Perëndimi trashëgimtarët e Sefer Fortuzit dhe veriut Adem Kallushi.

*Komisioni*

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga ish pronari, konstaton se është i plotë dhe konform kërkesave të ligjit 7698, datë 15.04.1993 dhe akteve të tjera nënligjore, si dhe pas verifikimit dhe azhornimit të bërë në vend duke mbajtur dhe

proces-verbalin përkatës vëren se nga sipërfaqa e përgjithshme e Shaqir dhe Hasan Katroshi prej 15 000 m², administratës ushtarake i janë shitur 10100 m². Sipas dokumentacionit rezulton se Shaqir Katroshi e ka shitur gjithë pjesën e tij prej 7500m², ndërsa Hasan Katroshi ka shitur vetëm diferencën e tokës prej 2600m². Kështu që në pronësi të Hasan Katroshit mbetet një sipërfaqe toke prej 4900m², e cila përbëhet si vijon:

- Truall i lirë me sipërfaqe të përgjithshme 3951m², që përbëhet prej dy parcelave $S_1$ brenda territorit të Uzinës Dinamo me sipërfaqe 2986 m² dhe $S_2$ jashtë territorit të saj me sipërfaqe 965m².
- Truall i zënë me ndërtime shtetërore me sipërfaqe të përgjithshme 298 m² i përbërë prej Drejtorisë së Projekteve $S_3$ me sipërfaqe 180 m² godinë banimi 5 katëshe $S_4$ me sipërfaqe totale 235m², në katin e parë të së cilës ka zënë një sipërfaqe prej 52m² qendra e edukimit të frontit demokratik të bllokut, dy ndërtesa 1 katëshe $S_5$ me sipërfaqe 66m², që janë në territorin e degës së drurit të Ndërmarrjes Artistike Migjeni.
- Truall i zënë me kioskë $S_6$ me sipërfaqe 25m².
- Truall i zënë me garazh $S_7$ me sipërfaqe 52m², që gjendet në territorin e degës së drurit.
- Truall i zënë me rrugë kalimi $S_8$ me sipërfaqe 391m².

Mbështetur në pikën 2/a të vendimit të KM nr. 304, datë 14.06.1993, Komisioni

## VENDOSI:

1. Të njohë ish pronarin Hasan Katroshi,n në bazë të Nenit 1 të ligjit 7689 datë 15.04.1993, të pronës së tij të përbërë prej një toke ndodhur në lagjen Ismail Efendi, në sinurin Hallias me sipërfaqe shtatë dynym e gjysëm, gjysmën e saj nga ana e jugut që kufizohet Met Daja, Perëndimi Trashëgimtarët e Sefer Fortuzit, Veriu me gjysmën tjetër që mori Shaqir Katroshi e Jugu Osman e Hamdi Maloku

Prona kthehet dhe kompensohet si vijon:

1a. Një truall i lirë me sipërfaqe të përgjithshme 3951 m², që përbëhet prej dy parcelash $S_1$ me sipërfaqe 2986 m² (që gjendet brenda territorit të uzinës Dinamo) dhe $S_2$ me sipërfaqe 965 m² jashtë territorit të Uzinës Dinamo (siç përcaktohet hollësisht në genplanin bashkëngjitur) dhe në bazë të nenit 19 të ligjit 7698 datë 15.04.1993 i njihet dhe i kthehet pronarit Hasan katroshi (trashëgimtarëve të tij), pronësia, mbi dy trojet e sipërshënuara: truall S1 kur të bëhet privatizimi i Uzinës Dinamo, ndërsa trualli S2 i kthehet pronarit menjëherë.

1b. Një truall i zënë me ndërtime të përkohshme me sipërfaqe të përgjithshme 77 m² (trualli $S_6$ me sipërfaqe 25 m² dhe garazh $S_7$ me sipërfaqe 52 m²) dhe në bazë të nenit 15 të ligjit 7698 datë

15.04.1993, i njihet dhe i kthehet pronarit Hasan Katroshi (trashëgimtarëve të tij) pronësia mbi këtë truall.

1c. Një truall i zënë me ndërtime shtetërore me sipërfaqe të përgjitshme 298 $m^2$ (Drejtoria e Projektimit, godinë 5 katëshe) $S_3$ me sipërfaqe 180$m^2$, salla e ish qendrës së frontit demokratik të bllokut $S_4$ që gjendet në krah të godinës 5 katëshe me sipërfaqe 52 $m^2$, dy ndërtesa 1 katëshe $S_5$ me sipërfaqe 66 $m^2$ të degës së drurit të Ndërmarrjes Artistike Migjeni) si dhe një truall i zënë me ndërtime të përhershme me sipërfaqe të përgjithshme 574 $m^2$ (godinë banimi 5 katëshe $S_4$ me sipërfaqe 183 $m^2$ dhe rrugë kalimi $S_8$ me sipërfaqe 391) dhe në bazë të nenit 16 të ligjit 7689 datë 15. 04.1993, kompensohet pronari Hasan Katroshi (trashëgimtarët e tij) për sipërfaqen e truallit të sipërshënuar me një nga mënyrat e përcaktuara në këtë nen.

1d. Në bazë të nenit 21 të ligjit 7698 datë 15.04.1993, pronarit Hasan katroshit (trashëgimtarëve të tij), i lind e drejta e privatizimit të Drejtorisë së Projektimit me sipërfaqe 180 $m^2$, salla e ish qendrës së frontit demokratik të bllokut me sipërfaqe 52 $m^2$ dhe dy ndërtesave 1 katëshe me sipërfaqe 66 $m^2$, kur ato të privatizohen.

Prona figuron e regjistruar në regjistrin Ipotekor me nr. 313 dhe 314, datë 24 prill 1942 që kufizohet: Lindja Mehmet Daja, Perëndimi Lulzim Fortuzi, Veriu Hasan katroshi dhe Jugu Hamdi e Osman Maloku

2. Kundër këtij vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rethit Tiranës.

3. Një kopje e këtij vendimi dërgohet për regjistrim në Hipotekë dhe në Kadastrën urbane.

KRYETARI I KOMISIONIT
HALIL BILBILI

Drejtoria e Privatizimit

Nr. Prot.

208/1

Tirane, me ... 1999

Lenda: Zvogelim Kapitali.

9. 6. 99

SH.A. "DINAMO"

TIRANE

Ne zbatim te Ligjit Nr. ...38, date 19.11.1992 "Per Shoqerite ...tare" neni 164, autorizoj Dr...orine e Shoqerise Anonime "Dinamo" ... per te bere zvogelimin e kapitalit per truallin e lire me siperfaqe 298...

Ky trualli ne baze te vendimit te Komisionit te Kthimit dhe ...esimit te Pronave Nr. 145, date 30.06.1995 i kthehet pronarit te truallit.

Ekspert kontabel i autorizuar per zvogelimin e kapitalit caktohet Zoti ...i Dari.

MINISTRI

Ylli BUFI

TIRANE

Tirane Sheshi "Skenderbej" Tel: (42) 328 33 Fax: (42) 340 52